



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 130 prot.

Kamëz, më 07.09.2022

V E N D I M

Nr. 111 Datë 07.09 2022

M B I

“MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË AMBJENTEVE PRIVATE PËR KOPSHTIN NR.2 “CAMARROKËT” DHE KOPSHTIN NR.17 “ËNGJËJT”.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 07.09.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.99 Datë 07.09.2022 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 ‘ Për vetëqeverisjen vendore’, neni 23 për “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, pika 11,e cila ngarkon Njësitë Bazë Të Qeverisjes Vendore me “Ndërtim, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale” si dhe pika 12, citojmë : “Bashkia administron dhe rregullon sistemin arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrjes me qira të ambienteve private për kopshtin vartës Nr. 2 “Çamarrokët dhe kopshtin Nr.17 Ëngjëjt”.
2. Fondi është parashikuar në buxhetin e vitit 2022, në zërin buxhetor Gr.0 Prog.09120art
3. Ngarkohen për zbatimin e procedurave të mëtejshme Drejtoria e Çështjeve Ligjore , si dhe Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit në Bashkinë Kamëz.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

